

RAPORTI MES PËRVOJËS DHE ARSYES TE LOCKE SI DHE TEJKALIMI
I KUNDËRTHËNIES SË TYRE NË FILOZOFINË E KANTIT

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I FILOZOFIS NË FILOZOFI

NGA

GENTIANA ÇERKINI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI FILOZOFI
PRISHTINË

NËNTOR, 2021

EKSPOZE E TEMËS

RAPORTI MES PËRVOJËS DHE ARSYES TE LOCKE SI DHE TEJKALIMI I KUNDËRTHËNIES SË TYRE NË FILOZOFINË E KANTIT

Mentor. Prof.Ass.Dr. Hasnije Ilazi

Tema në punim sillet rreth trajtimit të problematikës të filozofisë së John Locke e cila është raporti mes arsyes dhe përvojës dhe tejkalimi i kundërthënies së tyre në filozofinë e Kant-it. Kjo problematikë përfshin aspektet dy dimensionale që është aspekti teorik dhe praktik. Aspekti teorik ka të bëjë me teorinë empiriste, aspekti gnoseologjik se si është e mundur njohja njerëzore dhe cila janë fundamentet bazike nga e cila buron ajo. Dhe aspekti praktik ka të bëjë me elementet e teorisë politike të Locke e cila përfshin veprimtarinë filozofiko-politike. Nga ballafaqimi i këtyre dy qasjeve qon deri tek roli i arsyes dhe përvojës ku potencohen si ‘burime esenciale’ për arritjen e kuptimit të këtyre dy qasjeve. Ndërsa si zgjidhje mund të shohim mendimin e Kant ku burojnë idetë qendrore sa i përket raportit mes këtyre dy koncepteve që janë vendimtare në procesin e njohjes, si në atë teorik dhe praktik. Sepse nga veprimtaria filozofike e Kant kemi trajtimin e dy rrafshëve atë teorik që përfshin konceptet që mundësojnë njohjen njerëzore dhe ai praktik ku bën pjesë etika dhe drejtësia. Nga elaborimi i këtyre dy rrafshëve se si funksionojnë në raport me njohjen atëherë detektojmë mangësitë e Lockes në filozofinë e tij, ku potencojmë ‘paqëndrueshmëri’ ndërsa arrijmë në plotësimin e tyre pikërisht nga refleksionet filozofike të elaboruara në filozofinë Kantiane. Përpjekja ime është që të shtjelloj konceptet themelore të mendimit të Locke si nga aspekti teorik dhe atë praktik. Se si u zhvillua teoria e njohjes, me pjesët përbërëse dhe aspektin filozofiko-politik ku përshin gjendjen natyrore, të drejtat natyrore si ndër pjesët themelore të veprimtarisë së tij filozofike. Si dhe shpjegimi i njohjes e elementeve praktike përmes teorisë së Kant-it dhe rolin funksional të arsyes praktike.

PËRMBLEDHJE E KAPITUJVE

Punimi përbëhet prej katër kapitujve, ku tendenca kryesore është trajtimi i dy aspekteve të filozofisë së Locke, aspektin teorik dhe atë praktik. Si dhe elaborimi i refleksioneve filozofike të Kant-it si tendencë për detektimin e mangësive të filozofisë Locke ku qasja ime do të jetë kritike ndaj këtyre dy aspekteve të filozofisë së Locke . Dhe prandaj do të paraqes veprimtarin filozofike të Kant-it si zgjidhje ndaj këtyre mangësive.

Titulli i kapitullit të parë, është Locke një ndër themeluesit e parë të Iluminizmit. Elaborimi përqendrohet kryesisht në përcaktimin e mendimeve të Locke që mund ta fusin në rrafshin Iluminist, dhe se cilat janë ato pjesë që përbëjnë ato mendime Iluministe që janë trajtuar dhe kanë ndikuar në sfera të ndryshme, dhe që mund të cilësohen si burime të paradigmave të reja të mendimit iluminist. Si dhe trajtimi i aspektit gnoseologjik se cilat janë postulatet themelore që përbëjnë teorinë e njohjes kryesisht atë empiriste.

Titulli i Kapitullit të dytë, është Aspekti Gnoseologjik dhe Themelimin i Teorisë së njohjes te Locke, paraqiten postulatet të cilat përbëjnë teorinë e njohjes sepse do të jenë bazë për të kuptuar qasjen e tij ndaj aspektit praktik apo një rrafshi tjetër filozofik që është trajtuar brenda kuadrit të mendimit filozofik të Locke. Sepse pikërisht ky aspekt nevojitet për të paraqitur themi një ‘kontradiktë’ brenda veprimtarisë filozofike ku përfshihen dy aspektet. Ky kapitull përfshin elementet bazike të konstruktimit të teorisë empirike.

Titulli i kapitullit të tretë është Aspekti Politik, Konstituimi i Mendimit Politik bazuar në Kontekstin Racional. Kjo ka të bëjë me veprimtarin e filozofisë politike, pikërisht në këtë kapitull kam elaboruar elemente të cilat mund të paraqiten si pjesë e reflektimit racional pavarësisht asaj se Locke është përfaqësues në kuptim të plotë i empirizmit a mund të hasim në pika kyçe që mund ta lëkundin këtë përfaqësim, mbetet në shqyrtimin e kapitullit të tretë. Ku po ashtu është trajtimi se si mund të njohën elementet që ndërtohet një teori filozofike politike nga qasja Locke.

Titulli i kapitullit të katërt, është Kritika e Locke nga Kant-i si dhe Tejkalimi i Kontradiktës Empirizëm VS Racionalizëm. Në këtë kapitull në fokus janë idetë të cilat i hasin në filozofinë e Kant-it për ta tejkaluar boshllëku që hasim te Locke duke trajtuar teorinë e njohjes, si dhe ballafaqimin e dy teorive veçanërisht të drejtës në pronë. Ku vërehet qartazi se te Locke edhe pse afirmohet konteksti racional por jo në atë masë siç e kemi te Kant-i. Sepse përmes nocioneve dhe refleksione që hasin te Kant-i arrimë në plotësimin e mangësive veçanërisht përmes funksionit të arsyes praktike.

METODOLOGJIA

Metodologjia e përdorur për këtë punim merret si metodë kryesore metoda analitike dhe leximi kritik i tekstit, librave të autorëve dhe veprimtarëve të ndryshëm që shërbejnë si burim për me arrit deri tek konkluzionet dhe qasja kritike ndaj veprimtarsisë filozofike të John Locke. Burimet e përzgjedhura ofrojnë materialin për realizimin punimit ku këto burime mund të jenë; libra, fjalor dhe revista. Qasja teorike në punim ofron qasje të disa natyrave sa i përket problematikave që mund ti hasim në filozofinë e John Locke. Nga analiza e ideve të autorëve trajtuar në punim arrihet në ballafaqimin e disa pikave kryesore ku dalin përfundime si zgjidhje të disa problematikave që gjejmë në filozofinë e John Locke.